LIGJ
Nr.10 145, datë 28.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008
"PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 5 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Për dekretet e nxjerra nga Presidenti i Republikës, për lënie të shtetësisë shqiptare, të pazbatuara deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohet taksa e pullës.

Neni 3
Shfuqizimet

Vendimi nr.550, datë 1.8.2003, i Këshillit të Ministrave "Për tarifat e shërbimeve, që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër ligjore apo nënligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6280, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Shtojca nr.3

TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

		Masa e taksës (në lekë)
1.	Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
2.	Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë për lidhje martese” në gjuhë të huaj	200 lekë
3.	Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë lindjeje” në gjuhë të huaj	200 lekë
4.	Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë martese” në gjuhë të huaj	200 lekë
5.	Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
6.	Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë
7.	Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
8.	Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve	1 000 lekë